

Të gjeturat e këtij raporti përfshijnë të dhënat në lidhje me numrin e ankesave dhe shkeljeve të evidentuara nga OShP, listën e zezë, standardin e vendimmarrjes dhe konsistencën e vendimeve.

D+ ka monitoruar pothuajse të gjitha seancat e hapura të OShP-së, si dhe ka përcjellë në vazhdimësi shqyrtimin e ankesave të deponuara në këtë institucion.

Këtu përfshihen vendimet që janë marrë lidhur me pretendimet ankimore, urdhëresat e lëshuara për autoritetet kontraktuese si dhe gjokat që ju jepen të njëjtave për mosrespektimin e vendimeve të OShP-së.

Krahas kësaj, ky raport matë edhe progresin që OShP ka pasur nga fillimi i monitorimit e deri sot, veçanërisht sa i përket zbatimit të rekomandimeve që D+ i ka paraqitur në raportet e kaluara të monitorimit.